



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

MBROJTJA E KONSUMATORËVE

DËMSHPËRBLIMI I ISH-TË DËNUARVE POLITIKË

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE

ULJA E PAPANËSISË

SHMANGIA E TATIMIT TË DYFISHTË ME ARABINË SAUDITE

SHQIPËRIA MERR PJESË NË 100 VJETORIN E ILO NË GJENEVË

ZBATIMI I DETYRIMEVE TË KODIT TË PUNËS

PUNËSIMI PËRMES ZYRAVE TË PUNËS

DITARI JAVOR


10 Qershor - 16 Qershor 2019




Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Autoriteti i Mediave Audiovizuale nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi që synon të sigurojë mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve, gjatë praktikave tregtare të ofrimit të shërbimeve nga operatorët e fushës së mediave audiovizive. Ministria vlerësoi se marrëveshja i hap rrugë bashkëpunimit mes dy institucioneve në funksion të objektivave dhe strategjisë për mbrojtjen e konsumatorëve. Dy institucionet do të angazhohen të bashkëpunojnë për çështje si: hartimin dhe përmirësimin e akteve nënligjore; sigurimin e zbatimit sa me efektiv të legjislacionit ekzistues; shkëmbimin e informacioneve; organizimin e takimeve të përbashkëta; publikimin e të dhënave; etj.



Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka çelur këstin e njëmbëdhjetë të shpërndarjes së dëmshpërblimit për ish- të dënuarit politikë të regjimit komunist për subjektet përfituese të kategorisë parësore. Përfituesit e kategorisë parësore, të cilët presin t'ju disbursohet ky këst, përlogariten të jenë 70 në total, 20 prej të cilëve i likujdohet e plotë vlera e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave në këstin e 11-të. Fondi në dispozicion, i cili do të përdoret për likujdimin e këtij kësti, kap vlerën prej 55.216.887 lekë, ose e thënë ndryshe 15% e fondit total të miratuar të mbetur në dispozicion për këtë vit, i cili do të përdoret për likujdimin e këstit të 11-të. Urdhri për çeljen e këstit të 11-të u firmos nga Ministria Anila Denaj, në përfundim të likujdimit të këstit të 10-të për 75 subjekte përfituese të kategorisë parësore.



Investimet e huaja direkte vijuan trendin rritës edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2019. Banka e Shqipërisë konstatoi nëpërmjet të dhënave të Bilancit të Pagesave se "Fluksi i Investimeve të huaja direkte në formën e zgjerimit të kapitalit, vlerësohet në 266 milionë euro" në tre muajt e parë të këtij viti. Këto investime janë të përqëndruara kryesisht në sektorin e energjitikës (në masën 49%, të hidrokarbureve (në masën 18%) dhe ndërmjetësimit financiar (në masën 8%). Ruajtja e ritmit të rritjes së investimeve të huaja direkte është një sinjal pozitiv për ecurinë e ekonomisë së vendit. Në vitin 2018, investimet e huaja direkte në vend arritën në mbi 1 miliardë euro.



Anketa Tremujore e Forcave të Punës për Tremujorin e parë të vitit 2019 jep të dhëna pozitive në drejtim të uljes së papunësisë dhe rritjes së forcës punëtore në vend. Shkalla zyrtare e papunësisë në tremujorin e parë të vitit 2019 është 12.1 %, duke u ulur me 0.4 pikë përqindje në terma vjetorë dhe 0.2 pikë përqindje krahasuar me një tremujor më parë. Tendencë rënëse ka shfaqur papunësia te të rinjtë, e cila për T1 2019 është 2.3 pikë përqindje më e ulët krahasuar me T1 2018, duke shënuar normën 22,2 %. Sipas INSTAT, shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 60,3 % gjatë tremujorit të parë të këtij viti dhe në krahasim me të njëjtin tremujor të vitit 2018, numri i të punësuarve gjithsej u rrit me 1,4 %.



Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për Shmangien e Tatimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal në lidhje me Tatimin mbi të Ardhurat dhe Kapitalin" është miratuar nga Komisioni të Ekonomisë dhe Financës. Marrëveshja synon të nxisë investimet reciproke mes dy vendeve. Ajo konsiderohet si pararendëse e investimeve të dy vendeve dhe nëpërmjet eliminimit të dyfishtë të taksimit apo ndarjes së të drejtës së taksimit për të ardhurat dhe kapitalin të krijohen garancitë e nevojshme, për investitorët potencialë.



Sfidat e së ardhmes në botën e punës si dhe përvjetori i 100-të i Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ILO, bashkoi dhe delegacionin shqiptar me 6 mijë delegate nga e gjithë bota në Konferencën e 108-të Ndërkombëtare e Punës që po zhvillohet në Gjenevë të Zvicrës nga data 10 deri më 21 qershor 2019. Delegacioni shqiptar në këtë konferencë u kryesua nga Znj. Dajna Sorensen, Zv. Ministre e MFE, e cila përshëndeti seancën Plenare të Konferencës. Sorensen informoi se Qeveria shqiptare është e angazhuar për drejtësi sociale dhe punë të denjë.



Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit mes Inspektoriatit të Punës dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, e cila synon ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomikë mbi detyrimet që rrjedhin nga Kodi i Punës për të trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë punonjësit e tyre, pavarësisht gjinisë apo karakteristikave të tjera. Deklarimi nga ana e operatorëve ekonomikë mbi garantimin e zbatimit të dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës, mbrojtjen e të drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë diskriminimi, për lidhjen e kontratave të punës për çdo punëmarrës, si dhe garantimi i marrjes së të gjithave masave në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë, në mënyrë të veçantë për grupet e rrezikuara, do të sjellë ndikim të drejtpërdrejtë në marrëdhëniet e punësimit të çdo punëmarrësi.



1242 persona janë punësuar përmes zyrave të Punës në gjithë vendin gjatë periudhës 7 - 13 qershor 2019. Numrin më të madh të të punësuarve e ka qarku i Tiranës, me 428 persona, ndjekur nga qarku i Vlorës me 211 persona, qarku i Durrësit 194 persona, qarku i Korçës 76 Persona, qarku i Lezhës 71 persona, qarku i Elbasanit 65 persona, qarku i Fierit 61 persona, etj.